

Fjalim i deputetit Shpëtim Idrizi

03.07.2023

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Unë e kërkoja fjalën sot për t'i kujtuar këtij parlamenti që disa ditë më parë ishte data 27 qershor, ditë e njohur nga parlamenti i Shqipërisë me ligjin nr. 7839, datë 30.06.1994 “Për shpalljen e datës 27 qershor në kalendarin kombëtar si “Dita e Gjenocidit ndaj shqiptarëve të Çamërisë nga shovinistët grekë dhe ngritja e një memoriali””, dhe kjo është shoqëruar edhe me një rezolutë të këtij parlamenti.

Siç është e njohur botërisht, në fund të Luftës së Dytë Botërore, nga 27 qershori i vitit 1944, nga marsi deri në prill të vitit 1945, mbi popullsinë çame të pambrojtur u krye një nga gjenocidet e spastrimeve etnike nga më të pashembulltat në historinë e njerëzimit: 2770 jetë njerëzore u masakruan barbarisht dhe ata nuk u vranë në luftë, por u vranë në shtëpitë e tyre; 68 fshatra u rrafshuan dhe u dogjën; 159 fshatra të tjera u grabitën dhe rreth 30 mijë shqiptarë të Çamërisë u dëbuan nga tmerret e bandave paramilitare të Napolon Zervës. Rreth 2900 të tjerë vdiqën nga uria, etja, sëmundjet, në një rrugëtim biblik drejt Shqipërisë dhe ata sot prehen në varrezat monumentale të Kllogjërit, që shumë prej jush, fatkeqësisht, nuk i kanë vizituar.

Kjo është arsyeja që, në përkujtim të kësaj dite dhe të nderimit të mijëra jetëve të vrara, të të zhdukurve dhe të të përzhënëve, ju kërkoj, të nderuar kolegë deputetë, të mbajmë 1 minutë heshtje.

(Mbahet 1 minutë heshtje.)

I përjetshëm qoftë kujtimi i tyre!

Unë ju falënderoj shumë për nderimin, por më duhet t'i adresohem Kryetares së Kuvendit: ne, si grup parlamentar, kemi bërë një kërkesë që sot të kërkoja zyrtarisht 1 minutë heshtje për mijëra viktima të Çamërisë, asaj Çamërie, e cila, ashtu si Kosova, në vitin e mbrapshtë 1913, u sakrifikua për këtë Shqipëri politike që kemi sot, u sakrifikua pikërisht që ne të jemi deputetë në këtë sallë!

Ne ju adresuam, sepse kjo datë është, siç e thashë, një datë e njohur edhe me ligjin e parlamentit të Shqipërisë, si “Dita e gjenocidit mbi shqiptarët e Çamërisë” dhe besoj se është e paarsyeshme që Kryetarja e Kuvendit, e cila mungon gjithmonë në këto raste, të mos e bëjë këtë gjë në emër të Kuvendit të Shqipërisë, por më duhet të ngrihem unë si deputet dhe ta kërkoj këtë gjë për procedurë.

Ky parlament i nderuar ka bërë shumë rezoluta, ka kërkuar të nderohen, me të drejtë, raste të tilla gjenocidiale. Kemi bërë dhe kemi kërkuar rezolutë për Bosnjën, për Kosovën, për Holokaustin, për Khmerët e Kuq të Kamboxhias, për aborigjenët e Australisë dhe kemi bërë shumë mirë, të nderuar kolegë deputetë, sepse kjo kujtesë na ndihmon që t'ua tregojmë të gjithëve, në mënyrë që raste të tilla të mos përsëriten më.

Por jam i keqardhur që nuk ka akoma një deklaratë apo një rezolutë të këtij parlamenti për heqjen e ligjit të luftës me Greqinë dhe pikërisht për avancimin, si detyrim kushtetues edhe nga rezoluta e Shqipërisë, për çështjen e shqiptarëve të Çamërisë.

Faleminderit.